



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 1109/11 Prot.,

Tiranë, 01.3.2023

URDHËR

Nr. 125, datë 01.3.2023

**“PËR
RAPORTIN VJETOR TË AGJENCIVE TË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV DHE
SPORTEELIT UNIK S.U.A.D.A.”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të germës “f” të pikës 2, të nenit 157 dhe germës “ë” të pikës 2, të nenit 159 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit standard të raportit të detajuar të mbledhjes së tarifave nga përdoruesit dhe shpërndarjes së tyre te mbajtësit e së drejtës, me specifikimet si më poshtë vijon:

- a) Aneksi numër 1: Formular i Raportit Vjetor për Agjencitë e Administrimit Kolektiv.
- b) Aneksi numër 2: Formular i Raportit Vjetor për Sportelin Unik, S.U.A.D.A.
- b) Aneksi numër 3: Tabelë përmbledhëse mbi veprimtarinë financiare të agjencive së administrimit kolektiv.
- c) Aneksi numër 4: Tabelë e detajuar e të ardhurave për vitin financiar të subjektit raportues.
- ç) Aneksi numër 5: Tabelë e detajuar e shpenzimeve për vitin financiar të subjektit raportues.
- d) Aneksi numër 6: Tabelë e detajuar e shpërndarjeve të AAK-ve për të të drejtës së autorit.
- dh) Aneksi numër 7: Tabelë e detajuar për të ardhurat dhe shpërndarjet ndaj agjencive simotra.
- e) Aneksi numër 8: Tabelë e detajuar mbi veprimtarinë financiare të Sportelit Unik, S.U.A.D.A.
- ë) Aneksi numër 9: Tabelë e detajuar mbi pagesën për TVSH-në për Sportelin Unik, S.U.A.D.A.

- f) Aneksi numër 10: Tabelë mbi kategorinë e subjekteve paguese të të drejtës së autorit për Sportelin Unik, S.U.A.D.A.
2. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtës së Autorit për komunikimin e këtij urdhri dhe Agjencitë e Administrimit Kolektiv (AAK) dhe Sportelin Unik, S.U.A.D.A për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Elva MARGARITI





REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

FORMULAR I RAPORTIT VJETOR
Për Agjencitë e Administrimit Kolektiv

MINISTRIA E KULTURËS

Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, me shkronjë të madhe.

HAPËSIRË E REZERVUAR PËR INSITUCIONIN
Nr. Prot.,
Datë:

SEKSIONI 1. INFORMACION MBI AGJENCINË E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV

1. Agjencia e Administrimit Kolektiv:

2. Adresa (qyteti, rruga, tel., fax., numër postar):

3. Viti financiar i monitorimit:

4. Adresa e postës elektronike, e-mail:

5. Faqja zyrtare web:

6. Drejtori Ekzekutiv:

SEKSIONI 2. INFORMACION I PËRGJITHSHËM NË ZBATIM TË TË LIGJIT NR. 35/2016, I NDRYSHUAR.

1. Informacion të detajuar mbi statutin dhe rregulloren e AAK-së.

☐

2. Listë jo shteruese të anëtarëve dhe jo anëtarëve të të njëjtës kategori.

☐

3. Statement bankar për të gjitha llogaritë bankare në monedhë vendase dhe të huaj, të vulosur në cdo faqe nga banka përkatëse.

☐

4. Bilanci dhe pasqyrat financiare, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

☐

5. Raport të detajuar të aktivitetit të Agjencisë së Administrimit kolektiv për të gjithë vitin financiar.

☐

6. Përshkrim të detajuar të strukturës së Agjencisë së Administrimit Kolektiv.

☐

7. Vendimet e organeve të tyre më të larta drejtuese dhe vendimmarrëse shoqëruar me kopje përkatëse.

☐

8. Informacion mbi pagesat e personave ose subjekteve të përcaktuar në nenin 133, pika 2, gërma b), shkronja i) të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, për:

☐

a) shërbimet e mbikëqyrjen e administrimit ekonomiko-financiar të agjencisë.

☐

b) për ngritjen e komisionit të posaçëm.

☐

9. Raport të detajuar të shumave të shpenzuara për masat kundër piraterisë dhe falsifikimit, si dhe për masat e tjera që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të vlerës së të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të. Ky raport do të shoqërohet me dokumentacion provues të vlerës financiare përkatëse dhe detaje të aktivitetit.

☐

10. Kontratat e punës të lidhura ndërmjet AAK-së dhe punonjësve të agjencisë.

☐

11. Raportet e auditimit për veprimtarinë e tyre, të kryer nga auditues të brendshëm dhe/ose të jashtëm, të licencuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

☐

1. Informacion në lidhje me monitorimin e përdorimit të kategorisë së të drejtave që AAK-ja përfaqëson (shoqëruar me dokumentacionin përkatës).	☐
SEKSIONI 3. TË DHËNAT FINANCIARE	
1. Tabelë mbi veprimtarinë financiare të agjencisë së administrimit kolektiv.	☐
2. Tabelë e detajuar e të ardhurave për vitin financiar të subjektit raportues.	☐
3. Tabelë e detajuar e shpenzimeve për vitin financiar të subjektit raportues.	☐
4. Tabelë e detajuar e shpërndarjeve për vitin financiar të subjektit raportues.	☐
7. Tabelë e detajuar për të ardhurat dhe shpërndarjet ndaj agjencive simotra	☐
8. Të depozitohen listëpagesat, pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe deklarata e tatimit në burim dhe TVSH (të vulosura në çdo faqe).	☐
9. Listë të përditësuar të kontratave dypalëshe dhe shumëpalëshe të lidhura me agjencitë e huaja të administrimit kolektiv.	☐
SEKSIONI 4. ÇDO DOKUMENT TJETËR TË NEVOJSHËM	
1. Libër shitje dhe libër blerje për veprimtarinë financiare gjatë vitit.	☐
2. Informacion në zbatimin e pikës 9, të nenit 151 të ligjit nr 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", i ndryshuar, mbi tarifën e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të pa shpërndara nga AAK-ja dhe që depozitohen në një fond special për llogaritë të ministritë përgjegjëse për të drejtat e autorit.	☐
3. Zbatimin e pikës 1, të nenit 153 të ligjit nr 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", i ndryshuar, parashikohet se agjencitë e administrimit kolektiv kanë detyrimin për të publikuar, në format elektronik, në faqen e tyre të internetit, informacionin e përditësuar si më poshtë:	☐
a) Statutin;	☐
b) Listën e anëtarëve të organeve qendrore dhe vendore të administrimit, përbërjen e komisioneve të brendshme dhe listën e administratorëve lokalë;	☐
c) Deklaratën vjetore në lidhje me bilancin e shumave jo të shpërndara, shumat e mbledhura nga kategoritë e përdoruesve ose paguesve, shumat e mbajtura në burim, koston e administrimit dhe shumat e shpërndara nga kategoritë e pronarëve/autorëve;	☐
ç) Raportin vjetor;	☐
d) Informacion për Asambleen e Përgjithshme, për shembull: datën, vendin e thirrjes, agjendën, projektvendimet dhe vendimet e miratuara;	☐
e) Të dhëna të tjera të nevojshme për anëtarët, për qëllime informimi.	☐
4. Informacion mbi proceset gjyqësore, bashkëpunimet, investimet dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për verifikimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së Sportelit Unik, me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe me statutet e tyre.	☐

Sqarime:

Seksioni 2, Pika 3: Statement bankar për të gjitha llogaritë bankare në monedhë vendase dhe të huaj të vulosur në çdo faqe nga banka përkatëse.

Seksioni 2, Pika 11: Për efekt të raportit vjetor, Raporti i Auditit do të riprodhohet duke detajuar të gjitha gjetjet dhe argumentuar se si ato përputhen me dokumentacionet të cilat vendosen në dispozicion nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv.



FORMULAR I RAPORTIT VJETOR
Për Sportelin Unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve

MINISTRIA E KULTURËS

Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, me shkronjë të madhe.	HAPËSIRË E REZERVUAR PËR INSITUCIONIN Nr. Prot., Datë:
---	---

SEKSIONI 1. INFORMACION MBI SPORTELIN UNIK

1. Adresa (qyteti, rruga, tel., fax, numër postar):
2. Viti financiar i monitorimit:
3. Adresa e postës elektronike, e-mail:
4. Faqja zyrtare web:
5. Përfaqësuesit e Këshillit Mbikëqyrës:
6. Drejtori Ekzekutiv:

SEKSIONI 2. INFORMACION I PËRGJITHSHËM NË ZBATIM TË TË LIGJIT NR. 35/2016, I NDRYSHUAR.

1. Informacion të detajuar mbi statutin dhe rregulloren.	☐
2. Listë të subjekteve për vitin financiar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.	☐
3. Listë të autorizimeve nga Sporteli unik, S.U.A.D.A ndaj subjekteve përdorues për vitin financiar.	☐
4. Statement bankar për të gjitha llogaritë bankare në monedhë vendase dhe të huaj, të vulosur në çdo faqe nga banka përkatëse.	☐
5. Bilanci dhe pasqyrat financiare, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.	☐
6. Raport të detajuar të aktivitetit të Sporteli unik, S.U.A.D.A për të gjithë vitin financiar.	☐
7. Përshkrim të detajuar të strukturës së Sporteli unik, S.U.A.D.A.	☐
8. Vendimet e organeve më të larta drejtuese dhe vendimmarrëse shoqëruar me dokumentacionet përkatëse.	☐
9. Kontratat e punës të lidhura me stafin administrativ të Sporteli unik, S.U.A.D.A.	☐
10. Raportet e auditimit për veprimtarinë e tyre, të kryer nga auditues të brendshëm dhe/ose të jashtëm, të licencuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.	☐
11. Raporte të detajuara të monitorimit të përdorimit të kategorive të të drejtave nga përdorues të të drejtës së autorit (shoqëruar me dokumentacionin përkatës).	☐
12. Informacion mbi procesin vendimarrës për vitin raportues (vendimet, aktivitetet e përditshme përfshirë ato financiare).	☐
13. Informacion mbi të gjitha ankesat, kërkesat e palëve drejtuar Sportelit Unik dhe përgjigjet e kësaj të fundit.	☐
14. Situatën në lidhje me kategoritë e përdoruesve, numrin e paguesve të çdo kategorie, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me përdoruesit (autorizimet e lëshuara për subjektet përdorues, si dhe tarifat e paguara nga gjithësecili prej tyre.	☐

Informacion mbi hapësirën dhe logjistikën e përshtatshme, mekanizmat dhe ekspertizën profesionale, që përdoren për të realizuar mbledhjen kolektive të të ardhurave.	☐
16. Informacion mbi proceset gjyqësore, bashkëpunimet, investimet dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për verifikimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së Sportelit Unik, me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe me statutet e tyre.	☐
SEKSIONI 3. TË DHËNAT FINANCIARE	
1. Tabelë mbi veprimtarinë financiare të Sporteli unik, S.U.A.D.A.	☐
2. Tabelë e detajuar e të ardhurave për vitin financiar të subjektit raportues.	☐
3. Tabelë e detajuar e shpenzimeve për vitin financiar të subjektit raportues.	☐
4. Tabelë e detajuar e shpërndarjeve për vitin financiar të subjektit raportues.	☐
5. Tabelë e mbi kategorinë e subjekteve paguese të të drejtës së autorit për Sportelin Unik, S.U.A.D.A.	☐
6. Të depozitohen listëpagesat, pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe deklarata e tatimit në burim dhe TVSH (të vulosura në çdo faqe).	☐
SEKSIONI 4. ÇDO DOKUMENT TJETËR TË NEVOJSHËM	
1. Libër shitje dhe libër blerje për veprimtarinë financiare gjatë vitit.	☐
2. Informacion për detyrimin e publikimit në format elektronik, në faqen e tyre të internetit, informacionin e përditësuar si më poshtë:	☐
a) Sporteli unik, S.U.A.D.A publikon në faqen e saj zyrtare pjesën e të ardhurave që i shpërndan secilës AAK, shpërndarje e cila bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", i ndryshuar:	☐
b) Statutin:	☐
c) Emrat e përfaqësuesve të secilës AAK anëtar i Sporteli unik, S.U.A.D.A:	☐
ç) Listën e subjekteve përdoruesve apo të shoqatave të përdoruesve:	☐
d) Kontratat e lidhura me subjekteve përdoruesve apo të shoqatave të përdoruesve:	☐
dh) Shumën e të ardhurave të mbledhura:	☐
e) Kostot administrative:	☐
ë) Vendimet e mbledhjeve:	☐
f) Informacion për asamblenë e përgjithshme, për shembull: datën, vendin e thirrjen, agjendën, projektvendimet dhe vendimet e miratuara:	☐
h) Të dhëna të tjera për të siguruar transparencën ndaj të tretëve.	☐

Sqarime:

Seksioni 2, Pika 10: Për efekt të raporti vjetor, Raporti i Auditit do të riprodhohet duke detajuar të gjitha gjetjet dhe argumentuar se si ato përputhen me

ANEKSI NUMËR 3

Tabelë mbi veprimtarinë financiare të agjencisë së administrimit kolektiv _____

Nr.	Emërtimi	Llogaria në monedhën vendase (Lek)	Llogaria në monedhë të huaj	Total
I	Gjendje			
	Shuma e parave që agjencia ka gjendje në llogarinë e saj bankare në datën 1 janar, datë kur fillon përlllogaritja për vitin e ri financiar.			
II	Të ardhura nga Sporteli Unik S.U.A.D.A			
	Shuma e parave që janë depozituar në llogarinë e AAK-së nga Sporteli Unik S.U.A.D.A.			
	Të ardhura të tjera			
	Shuma e parave që janë depozituar në llogarinë e AAK-së nga palë të treta (interesa bankare, të ardhura nga agjencitë simotra, etj.)			
	Kthime			
	Shuma e parave që kanë hyrë në llogarinë bankare të AAK-së si kthime nga pagesa të cilat nuk janë kryer			
III	Shuma e parave të arkëtuara në llogarinë bankare të agjencisë*			
IV	Shpërndarjet			
	Shuma e parave të cilat i janë shpërndarë mbajtësve të së drejtës, anëtar ose joanëtar të agjencisë si dhe AAK-së simotra, gjatë vitit financiar, duke ju referuar statement bankar.			
	Tatimi mbi shumën e shpërndarë			
	Tatimi i paguar në kuadër të kësaj shpërndarje (15% x shumën e shpërndarë).			
	+ Shuma e parave të cilat i janë shpërndarë mbajtësve të së drejtës gjatë periudhës janar-mars të vitit pasardhës, për llogari të vitit financiar në të cilin kryhet analiza financiare.			
	- Tatimi i paguar në kuadër të kësaj shpërndarje (15% x shumën e shpërndarë).			
	- Shuma e parave të cilat i janë shpërndarë mbajtësve të së drejtës gjatë periudhës janar-mars të vitit aktual, por janë përlllogaritur si pjesë e shpërndarjeve për vitin paraardhës.			
	- Tatimi i paguar në kuadër të kësaj shpërndarje (15% x shumën e shpërndarë).			
	Totali i shpërndarjeve			
	Shpenzimet			
	Shuma e parave të cilat janë përdorur si shpenzime administrative gjatë vitit financiar.			

V	Tatimi i paguar - Shpenzimeve administrative të vitit financiar i zbritet Tatimi i paguar sepse është një pagesë që kryhet në emër të mbajtësve të së drejtave.			
	Totali i shpenzimeve			
VI	Përqindja e shpenzimeve kundrejt shpërndarjes*			
	Gjendje			
VII	Shuma e parave që agjencia ka gjendje në llogarinë e saj bankare në datën 31 dhjetor, datë kur përfundon përllogaritja për vitin financiar			

Sqarime:

* Shuma e parave të arkëtuara në llogarinë bankare të AAK-së është shumator i: Të ardhura nga Sporteli unik, S.U.A.D.A., të ardhura të tjera dhe kthime.

* Përqindja e shpenzimeve kundrejt shpërndarjes përllogaritet si raport i shpenzimeve kundrejt shpërndarjeve (shpenzime/shpërndarje)

ANEKSI NUMËR 4

Tabelë e detajuar e të ardhurave për vitin financiar të subjektit raportues:

Viti _____, Subjekti _____

Nr.	Data	Subjekti	Vlera në lek
TOTALI			

- * Të ardhurat të përlogariten në rend kronologjik referuar statement bankar.
- * Të detajohen burimet e të ardhurave për vitin financiar.
- * Të ardhurat do të pasqyrohen në monedhën lekë.
- * Kursi i këmbimit do ti referohet kursit mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë .

ANEKSI NUMËR 5

Tabelë e detajuar e shpenzimeve për vitin financiar të subjektit raportues:
Viti _____, Subjekti _____

Nr.	Data	Emërtimi i shpenzimeve	Vlera në lek
TOTALI			

- * Të detajohet çdo shpenzim operacional dhe financiar.
- * Të detajohen burimet e përdorura për të mbuluar shpenzimet administrative.
- * Shpenzimet të përlogariten në rend kronologjik referuar statement bankar.

ANEKSI NUMËR 6

Tabelë e detajuar e shpërndarjeve për vitin financiar të subjektit raportues:

Viti _____, Subjekti _____

Nr.	Data	Mbajtësi i së drejtës ose Agjencia e Administrimit Kolektiv	Vlera në lek
TOTALI			

- * Shuma totale e paguar për mbajtësit e të drejtave, anëtar ose jo anëtar, vendas ose i huaj ose për AAK-të
- * Shumën specifike të shpërndarë për secilin mbajtës të të drejtave anëtar ose jo anëtar, vendas dhe të huaj, për të drejtat përkatëse respektive.
- * Frekuenca e shpërndarjes së të ardhurave.
- * Të ardhurat e pashpërndara.
- * Të ardhurat e pashpërndara në zbatim të nenit 151, pika 6, të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar.

ANEKSI NUMËR 7

Tabelë e detajuar për të ardhurat dhe shpërndarjet ndaj agjencive simotra
Viti _____, Subjekti _____

Nr.		Data	Agjencia e huaj e administrimit kolektiv	Vlera në lek
	Të ardhura			
	Shpërndarje			
TOTALI				

* Shuma totale e të ardhurave nga agjencitë simotra;

* Shuma totale e të ardhurave për agjencitë simotra;

* Shuma e të ardhurave të shpërndara për mbajtësit e të drejtave të gjeneruara nga agjencitë e tjera simotra.

ANEKS NUMËR 8

Tabelë e detajuar mbi veprimtarinë financiare të Sportelit Unik, S.U.A.D.A.

Viti financiar _____



Nr.	Emërtimi	Llogaria në monedhën vendase (Lek)
I	Gjendje	
	Shuma e parave që ka gjendje në llogarinë bankare Sporteli Unik, S.U.A.D.A. në datën 1 janar, datë kur fillon përlllogaritja për vitin e ri financiar	
II	Të ardhurat për Sportelin Unik, S.U.A.D.A.	
	Shuma e parave që janë depozituar në llogarinë e në llogarinë bankare të Sportelit Unik, S.U.A.D.A. nga subjekte për të drejtën e autorit	
III	Shpërndarjet	
	Shuma e parave të cilat i janë shpërndarë AAK-ve gjatë vitit financiar, duke ju referuar statement bankar.	
IV	Shpenzimet	
	Shuma e parave të cilat janë përdorur si shpenzime administrative gjatë vitit financiar.	
V	Pagesë për TVSH	
IV/III	Përqindja e shpenzimeve kundrejt shpërndarjes = shpenzime / shpërndarje	
VI	Gjendje	
	Shuma e parave që Sporteli Unik, S.U.A.D.A. ka gjendje në llogarinë e saj bankare në datën 31 dhjetor, datë kur përfundon përlllogaritja për vitin financiar.	

ANEKSI NUMËR 9

Tabelë e detajuar mbi pagesën për TVSH-në për Sportelin Unik, S.U.A.D.A.

Nr.	Data	TVSH	Vlera në lek
TOTALI			

* Të detajohet çdo pagesë e TVSH e kryer nga Sporteli Unik S.U.A.D.A



ANEKSI NUMËR 10

Tabelë mbi kategorinë e subjekteve paguese të të drejtës së autorit për Sportelin Unik, S.U.A.D.A.

Nr.	KATEGORIA E SUBJEKTIT	TË ARDHURAT	PËRQINDJE E SUBJEKTEVE PAGUESE*	PËRQINDJE E TOTALIT TË TË ARDHURAVE*
1	OSHMA			
2	NJESI TREGTARE			
3	HOTELE			
4	RESTORANTE/BAR KAFE			
5	EVENTE			
TOTAL				

Sqarime

* Krahasimisht me totalin e subjekteve të të njëjtës kategori